

Raport individual për rezultatin e konsultimit publik,

për projektligjin:

“Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës”

1. Titulli i projektligjit

“Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm, të lartë, “Liceu Francez i Korçës””.

Projektligji “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës”” ka për objekt përcaktimin e kuadrit ligjor për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, Liceu Francez i Korçës (në vijim Liceu), i orientuar në fushën e të nxënësve shkencë dhe inovacion, që ushtron veprimtarinë në qytetin e Korçës.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një qasje rajonale dhe ndërkombëtare, duke zhvilluar partneritete arsimore, kulturore, shkencore franko-shqiptare, si dhe të vazhdojë traditën e bashkëpunimit arsimor frankofon të Liceut të Korçës.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Konsultimi nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike u realizua në përputhje me përcaktimet e nenit 15 të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 10.3.2026 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 10.4.2026, duke respektuar afatin prej 20 ditë pune.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës””, janë si më poshtë vijon:

- Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në link-un:
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/939>
- Nëpërmjet adresës postare: Adresa: “Rruga e Durrësit”, nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail-i i koordinatorit të konsultimit publik në MA: nadire.pilavi@arsimi.gov.al

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Arsimit të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit nr. 409, datë 25.8.2025 të Ministrit të Arsimit “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për hapjen e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, Liceut Franko-Shqiptar të Shkencave dhe Inovacionit, Korçë”. Pjesë e grupit të punës është edhe një ekspert francez, në zbatim të ligjit nr.

64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” ku përcaktohet angazhimi për identifikimin dhe zbatimin e projekteve prioritare, strategjike në sektorë të ndryshëm përfshirë arsimin.

Projektligji është planifikuar në PPAP 2026 dhe planin vjetor të konsultimit publik për vitin 2026.

Projektligji “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës””, u publikua për konsultim në RENJK, duke pritur sugjerime për projektligjin.

Numri i shikimeve në RENJKP për këtë projekt ishte 949 dhe procesi i konsultimit është shoqëruar me komente, nga qytetarët, pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik, në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ka pasur 13 komente apo propozime të caktuara mbi përmbajtjen e projektligjit, të cilat janë përcjellë nëpërmjet RENJKP.

Nga 13 komente, 2 (dy) prej tyre janë pranuar, ndërsa 11 të tjerat janë refuzuar.

- 3 (tre) komente janë refuzuar, pasi komenti lidhej me ndërhyrje jashtë objektit të projektaktit,
- 8 (tetë) komente janë refuzuar, pasi komenti gjen zgjidhje në një projektakt tjetër ligjor/nënligjor.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Hyrje	Projektligji në shqyrtim synon të krijojë kuadrin ligjor për themelimin dhe funksionimin e Liceut Francez të Korçës si institucion publik i arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë. Nisma përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit arsimor ndërkombëtar dhe rikthimit të traditës historike frankofone në qytetin e Korçës. Megjithatë, analiza e dispozitave të projektligjit evidenton një sërë problematikash të natyrës juridike, institucionale dhe të politikave publike. Ky dokument synon të ofrojë një vlerësim kritik të	Z. Taulant Muka	I pranuar	Nuk paraqitet një koment konkret për t'u trajtuar në kuadër të konsultimit publik.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	projektligjit, duke u fokusuar në qartësinë normative, strukturën e qeverisjes, garantimin e autonomisë, barazinë në akses dhe implikimet sistemike për arsimin publik në Shqipëri.			
Autonomia institucionale dhe struktura e qeverisjes	Projektligji e përcakton Liceun si person juridik publik me autonomi administrative dhe financiare. Megjithatë, analiza e dispozitave përkatëse tregon se autonomia e parashikuar është kryesisht formale. Organi kryesor vendimmarrës, Këshilli administrativ, kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose përfaqësuesi i tij	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Për pjesën e pavarësisë institucionale që përmendet, nuk mund të përdorim termin pavarësi sepse jemi në kushtet e institucionit të arsimit të mesëm publik që patjetër është nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe të institucioneve të saj të varësisë. Përdoret vetëm termi autonomi në nenin 4 të projektligjit ku

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet per regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe permbledhni komente identike/te ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	dhe përbëhet kryesisht nga përfaqësues të autoriteteve shtetërore shqiptare dhe franceze. Kjo strukturë kufizon ndjeshëm pavarësinë institucionale dhe krijon një varësi të drejtpërdrejtë nga pushteti ekzekutiv. Mungesa e përfaqësimit të aktorëve të pavarur, si ekspertë të arsimit, përfaqësues të komunitetit apo akademikë, dobëson më tej balancën e brendshme të qeverisjes. Për rrjedhojë, autonomia e deklaruar nuk mbështetet nga mekanizma efektivë institucionalë.			citohet se "Liceu është person juridik publik, i cili gëzon autonomi administrative dhe financiare në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi". Për sa i përket mungesës së përfaqësimit të aktorëve të pavarur, përfaqësues akademikë nuk mund të kemi, sepse jemi në kushtet e institucionit arsimor para universitar. Në nenin 5 të projektligjit në shkronjat "c" dhe "ç" përcaktohet se në Këshillin Administrativ do të ketë një ekspert financiar dhe një ekspert në fushën e arsimit para

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				universitar të caktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë. Eksperti mund të jetë si nga komuniteti edhe nga bota akademike, por jo domosdoshmërisht pasi kryesisht do të jenë ekspertë në fushën e arsimit para universitar. Autonomia mbështetet nga mekanizma efektivë pasi është siguruar përfaqësimi në Këshillin administrativ. Në organet vendimmarrëse duhet të ketë kryesisht përfaqësi nga strukturat që financojnë

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				institucionin, pra nuk mund të marrim nga komuniteti apo diku tjetër, nëse nuk janë financues të institucionit, ndërsa në organet konsultative mund të ketë përfaqësi të tjera.
Balanca institucionale dhe ndikimi ndërkombëtar	Projektligji parashikon një rol të rëndësishëm për autoritetet franceze në drejtimin dhe funksionimin e institucionit, përfshirë propozimin e drejtorit dhe mbikëqyrjen e një pjese të kurrikulës. Ndërkohë që bashkëpunimi ndërkombëtar është një element pozitiv, mënyra e institucionalizimit të këtij bashkëpunimi ngre shqetësime për	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Në projektligj ka një përfaqësim të balancuar të të dy shteteve, pra midis përfaqësuesve të palës shqiptare dhe asaj franceze. Në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës “Për kontributin në zbatimin e

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	balancën ndërmjet palëve dhe për respektimin e sovranitetit të politikave arsimore kombëtare. Mungesa e një përcaktimi të qartë të kufijve të ndërhyrjes së autoriteteve të huaja dhe e hierarkisë së normave ligjore mund të krijojë paqartësi dhe konflikte kompetencash në zbatim.			projekteve prioritare në Shqipëri”, të ratifikuar me ligjin nr. 64/2024, ku ndër fushat prioritare të bashkëpunimit parashikohet bashkëpunimi ndërmjet palëve për nxitjen për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore para universitare franceze në Republikën e Shqipërisë, në nenin 2 të tij përcaktohet se: “Nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore para universitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet per regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe permbledhni komente identike/te ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.” Për sa më sipër, në zbatim të marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				Francës, jepet mundësia që këto dy shtete të krijojnë bashkëpunime për hapjen e institucioneve para universitare, pra kemi një ligj kuadër që jep mundësinë e realizimit të këtyre bashkëpunimeve. Për sa kohë në projektligj, i cili parashikon ngritjen dhe funksionimin e një institucioni arsimor publik të ndryshëm nga institucionet arsimore para universitare që rregullohen në bazë të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tij, siç do të ketë

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				përfaqësi nga të dy shtetet, ashtu si dhe do ketë edhe kompetenca të përbashkëta. Nuk ka anim të balancës nga pala franceze pasi në projektligj është përcaktuar përfaqësia nga të dyja palët p.sh, drejtori do të jetë francez dhe nëndrejtori shqiptar. Këshilli Administrativ ka më shumë përfaqësi shqiptare. Detyrat dhe funksionet janë të qarta për të dyja palët. E njëjta gjë vlen edhe për Këshillin e institucionit. Për sa kohë do të ketë edhe kurrikul të huaj, mbikëqyrja do të bëhet nga pala franceze për kurrikulën e huaj dhe nga pala

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				shqiptare për kurrikulën shqiptare. Projektligji garanton respektimin e sovranitetit të politikave arsimore kombëtare dhe përfaqësia e autoriteteve të huaja nuk e cenon hierarkinë e normave ligjore dhe as krijon paqartësi dhe konflikte kompetencash në zbatim, pasi siç u shpjegua më lart, mbikëqyrja do të bëhet nga pala franceze për kurrikulën e huaj dhe nga pala shqiptare për kurrikulën shqiptare, pa u cenuar legjislacioni shqiptar.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Paqartësi në ndarjen e kompetencave	Projektligji nuk ofron një ndarje të qartë dhe të strukturuar të kompetencave ndërmjet organeve drejtuese. Këshilli administrativ ushtron kompetenca të gjera që përfshijnë edhe orientime pedagogjike, ndërsa drejtori ka funksione ekzekutive dhe koordinuese në fushën arsimore. Këshilli i institucionit mbetet në rol këshillimor. Ky konfigurim krijon rrezik për mbivendosje funksionesh dhe mungesë qartësie në vendimmarrje, duke e bërë sistemin e drejtimit potencialisht joefektiv dhe të ndjeshëm ndaj	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Në projektligj janë përcaktuar qartësisht rolet dhe detyrat e të gjitha strukturave. Ky koment nuk i referohet një neni konkret.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	konflikteve të brendshme.			
Aksesi dhe barazia sociale	Projektligji parashikon financim të përzier, duke përfshirë fonde publike dhe të ardhura nga tarifat e shkollimit. Megjithatë, nuk parashikohen mekanizma të detyrueshëm që garantojnë akses të barabartë për nxënësit nga shtresa të ndryshme socio-ekonomike. Mungesa e dispozitave për bursa, kuota sociale apo forma të tjera mbështetjeje financiare krijon rrezikun që institucioni të funksionojë si një shkollë elitare brenda sistemit publik, duke cënuar parimin e barazisë në arsim	Z. Taulant Muka	I pranuar	Referuar këtij komenti, në projektligj u bënë disa ndryshime, konkretisht si më poshtë: - në nenin 15, pika 3, shkronja “b”, ndryshohet si vijon "të ardhurat nga tarifat e shkollimit për nxënësit e huaj, shërbimet e ofruara, donacionet, trashëgimitë dhe sponsorizimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi"; - në nenin 17 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje “Për rregulla që nuk përcaktohen me këtë ligj, institucioni zbaton legjislacionin për

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				arsimin para universitar”. Në këtë mënyrë perkujdesja për kategori të veçanta të nxënësve, zhvillimi i mekanizmave të detyrueshëm që garantojnë akses të barabartë për nxënësit nga shtresa të ndryshme socio-ekonomike do të realizohet siç kryhet edhe sot në institucionet arsimore para universitare publike, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Delegimi i dispozitave në akte nënligjore	Një pjesë e konsiderueshme e elementeve thelbësore të funksionimit të institucionit lihet për t'u rregulluar në akte nënligjore ose rregullore të brendshme. Këto përfshijnë procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve, kriteret e pranimit dhe organizimin e brendshëm. Ky delegim i gjerë dobëson sigurinë juridike dhe transparencën, pasi vendimmarrja reale zhvendoset nga niveli ligjor në atë administrativ, duke kufizuar kontrollin publik dhe parlamentar.	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Në pikën 2 të nenit 13 përcaktohen qartë procedurat e punësimit për shtetasit shqiptarë. sipas legjislacionit në fuqi në RSH, ndërsa për shtetasit e huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar për punësimin e shtetasve të huaj, si dhe kriteret e pranimit të nxënësve. Kompetencat e organeve drejtuese vendimmarrëse apo këshillimore dhe te autoriteteve drejtuese përcaktohen drejtpërdrejt në projektligj, ndërsa përcaktimet më të hollësishme përcaktohen në

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				rregulloren e brendshme të institucionit, ndërsa kriteret e pranimit për nxënësit janë përcaktuar në nenin 12 të projektligjit. Detajimet do të jepen në rregulloren e institucionit.
Kurrikula dhe njohja e diplomave	Projektligji synon integrimin e kurrikulave shqiptare dhe franceze dhe pajisjen e nxënësve me dy diploma. Megjithatë, mungojnë detaje mbi mekanizmat e harmonizimit të standardeve dhe të njohjes reciproke të rezultateve. Paqartësia në këtë aspekt mund të ndikojë në cilësinë dhe besueshmërinë e sistemit të	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Dispozitat e parashikuara në nenin 10 të projektligjit adresojnë në mënyrë të qartë këtë çështje. Konkretisht, kurrikula parashikohet të zbatohet mbi bazën e një bashkërendimi koherent të dy sistemeve arsimore, duke ruajtur integritetin dhe standardet përkatëse të

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	vlerësimit, veçanërisht në raport me Maturën Shtetërore shqiptare.			secilit shtet. Lëndët që zhvillohen në gjuhën shqipe do të jenë plotësisht në përputhje me kurrikulën kombëtare shqiptare të arsimit të mesëm të lartë, ndërsa lëndët që zhvillohen në gjuhën frënge bazohen në kurrikulën e miratuar nga autoritetet përkatëse franceze. Në këtë kuadër, nxënësit pajisen me dy diploma – Maturën Shtetërore Shqiptare dhe Baccalauréat Francez – në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse të

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				secilit shtet, duke garantuar njohjen reciproke të rezultateve sipas standardeve përkatëse. Sa i takon mekanizmave të harmonizimit dhe vlerësimit, projektligji përcakton se këto do të detajohen përmes protokolleve të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve arsimore shqiptare dhe franceze. Këto protokolle do të sigurojnë qartësi procedurale dhe standardizim të proceseve, duke garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e sistemit të vlerësimit, përfshirë edhe raportin me

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				Maturën Shtetërore.
Regjimi i personelit dhe trajtimi i stafit të huaj	Projektligji parashikon një regjim të veçantë për personelin mësimor të huaj, duke përfshirë lehtësime administrative, fiskale dhe doganore. Megjithëse këto masa mund të justifikohen me synimin për të tërhequr ekspertizë ndërkombëtare dhe për të rritur cilësinë e mësimdhënies, mënyra se si janë konceptuar ato ngre shqetësime serioze në raport me parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme në tregun e punës. Në veçanti, projektligji nuk ofron një arsyetim të mjaftueshëm pse këto lehtësime	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Me këtë projektligj nuk i garantohet mbrojtje e veçantë të huajve. Në pikën 4 të nenit 14 përcaktohet se të ardhurat e personelit arsimor të huaj tatohen në bazë të dispozitave në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe legjislacionin përkatës tatimor dhe përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve doganore. Kjo është arsyeja pse te regjimi doganor është trajtuar vetëm statusi për shtetasit e huaj, pasi vendasit nuk

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	duhet të lidhen ekskluzivisht me statusin e të qenit “i huaj”, dhe jo me nivelin e kualifikimit, përvojës apo meritës profesionale. Një qasje e tillë krijon një diferencim artificial ndërmjet personelit vendas dhe atij të huaj, duke privilegjuar këtë të fundit në mënyrë të përgjithshme dhe pa kritere të qarta meritokratike. Kjo mund të prodhojë pasoja të padëshiruara në disa drejtime. Së pari, rrezikon të dekurajojë profesionistët shqiptarë, përfshirë ata të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, të cilët mund të kenë arritje të barabarta apo edhe më të larta, por që			lidhen me aspektin doganor. Ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të cilat funksionojnë vetëm për shtetasit e huaj. Pra, këtu i jemi referuar legjislacionit në fuqi.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbli dhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	nuk përfitojnë nga i njëjti regjim favorizues. Së dyti, bie në kundërshtim me politikat e deklaruara për nxitjen e “brain gain”, pasi krijon një mjedis ku kapitali njerëzor vendas nuk trajtohet në mënyrë konkurruese dhe të barabartë. Në këtë kuptim, projektligji rrezikon të institucionalizojë një formë preferenciale trajtimi mbi bazë të origjinës, në vend që të ndërtojë një sistem të bazuar në meritë dhe kompetencë. Një qasje më e balancuar do të kërkonte që çdo lehtësim apo stimul të lidhej me kritere objektive profesionale dhe nevoja konkrete			

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	institucionale, dhe jo me shtetësinë e individit.			
Parimi i barazisë dhe fragmentimi i sistemit arsimor publik	Projektligji ngre shqetësime serioze në lidhje me respektimin e parimit të barazisë në arsimin publik. Krijimi i një institucioni me status të veçantë ligjor, strukturë të diferencuar dhe mbështetje të konsiderueshme financiare e ndërkombëtare rrezikon të krijojë një trajtim të pabarabartë krahasuar me gjimnazet e tjera publike. Në vend që të fokusohet në përmirësimin sistematik të cilësisë së arsimit, përfshirë forcimin e standardeve të Maturës Shtetërore dhe rritjen e cilësisë	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Me këtë projektligj është kërkuar të krijohet një institucion elitar i fokusuar në shkencë dhe inovacion, në kuadër të ndërkombëtarizimit, duke sjellë ekspertizën më të mirë ndërkombëtare. Sa i takon fjalën “gjimnaz”, në nenin 1 të projektligjit përcaktohet se institucioni është i orientuar në shkencë dhe inovacion dhe jo gjimnaz.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet per regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe permbledhni komente identike/te ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	në të gjitha institucionet, projektligji orienton burime drejt një modeli të veçuar. Kjo qasje mund të çojë në krijimin e institucioneve elitare brenda sistemit publik dhe në thellimin e diferencave ndërmjet shkollave. Në këtë kontekst, lind një pyetje thelbësore e politikë bërjes: pse ndërhyhet përmes një ligji të posaçëm për një institucion të vetëm, në vend që të investohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së diplomës së Maturës Shtetërore shqiptare dhe në forcimin e të gjithë rrjetit të arsimit të mesëm publik?			

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Implikimet sistemike dhe precedenti ligjor	Projektligji përfaqëson një akt të posaçëm për një institucion të vetëm, duke krijuar precedent për fragmentimin e kuadrit ligjor në arsimin parauniversitar. Kjo mund të çojë në mungesë koherence në politikat arsimore dhe në trajtime të diferencuara ndërmjet institucioneve të ngjashme. Një qasje më e qëndrueshme do të ishte integrimi i modeleve të arsimit ndërkombëtar brenda një kuadri të përgjithshëm ligjor për sistemin arsimor.	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Ndryshimi i kuadrit rregullator ekzistues nuk do të sillte mundësinë e krijimit të Liceut Francez të Korçës. Mënyra e saj e re konceptuale e organizimit dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës duhet të jetë e rregulluar me një ligj të posaçëm, me qëllim krijimin e një modeli modern dhe inovativ të arsimit para universitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë, që përcjell një mënyrë të re organizimi,

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				administrimi dhe financimi. Miratimi i një ligji të veçantë është i nevojshëm pasi ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar rregullon organizimin e përgjithshëm të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe nuk parashikon modele të veçanta institucioneve me administrim të përbashkët ndërkombëtar dhe kurrikulë të dyfishtë. Liceu Franko-Shqiptar parashikon një strukturë të veçantë drejtimi me përfshirjen e autoriteteve franceze,

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				zhvillimin e mësimin në disa gjuhë dhe zbatimin e një kurrikule të integruar që çon në dy diploma shtetërore. Këto elemente kërkojnë rregullime specifike për organizimin, financimin, rekrutimin e personelit të huaj dhe njohjen e dokumenteve shkollore, të cilat nuk parashikohen nga kuadri aktual ligjor. Për këtë arsye është e nevojshme një ligj i posaçëm që të përcaktojë statusin dhe funksionimin e këtij institucioni.
Përfundime	Projektligji për Liceun Francez të Korçës paraqet një iniciativë me	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Projektligji synon të krijojë një formë të institucioneve

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	potencial për të kontribuar në ndërkombëtarizimin e arsimit shqiptar. Megjithatë, në formën aktuale, ai karakterizohet nga dobësi të rëndësishme në aspektin e qeverisjes institucionale, qartësisë juridike dhe respektimit të parimeve të barazisë dhe autonomisë. Ekziston rreziku që ky projektligj të krijojë një institucion me autonomi të kufizuar, ndikim të lartë politik dhe ndërkombëtar, si dhe akses të pabarabartë për nxënësit. Përmirësimi i tij kërkon një rishikim të thelluar të dispozitave që lidhen me strukturën e			arsimore para universitare që nuk është e parashikuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim ofrimin e një shërbimi arsimor sa më cilësor sipas modeleve më të mira të hartuara në bashkëpunim me ekspertë francezë. Propozimi për këtë projektligj vjen edhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji kuadër nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	drejtimit, ndarjen e kompetencave, garantimin e barazisë sociale dhe kufizimin e delegimit në akte nënligjore. Një reformë e qëndrueshme në arsim do të kërkonte një qasje më gjithëpërfshirëse, të orientuar drejt forcimit të cilësisë në të gjithë sistemin publik, në vend të krijimit të institucioneve të veçuara me status të privilegjuar.			Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” ku përcaktohet angazhimi për identifikimin dhe zbatimin e projekteve prioritare strategjike në sektorë të ndryshëm përfshirë turizmin, menaxhimin e ujit, mjedisin, inovacionin, digjitalizimin, energjinë, reformën në administratën publike, transportin, arsimin, shëndetësinë dhe bujqësinë, që ka si

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				qëllim transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin profesional të fuqisë punëtore, që do të kontribuojë në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Palët për arritjen e këtij qëllimi do të ndajnë informacionin përkatës për këto projekte dhe do të identifikojnë financimin për të mbështetur zbatimin e tyre. Konkretisht në nenin 2 të këtij ligji përcaktohen mënyrat prioritare të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri siç janë nxitja e bashkëpunimit në fushën e arsimit para universitar, përfshirë arsimin dhe formimin profesional (VET/AFP), arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore para universitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.
Efikasiteti ekonomik dhe prioritetet e politikës publike	Analiza e raportit shoqërues të projektligjit (Relacioni) evidenton një disproportcion të theksuar ndërmjet kostos së parashikuar për Liceun Francez të Korçës dhe kostos së funksionimit të një gjimnazi publik standard në Shqipëri. Sipas të dhënave zyrtare,	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Vlerësohet se argumentet financiare të paraqitur nuk reflektojnë (ose nuk është kuptuar në mënyrë të plotë) natyra e institucionit "Liceu Francez i Korçës". Krahassimi i kostos për nxënës me një gjimnaz standard publik nuk është i

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	kostoja mesatare për nxënës në këtë institucion vlerësohet rreth 8,400–8,800 euro në vit, ndërkohë që në një gjimnaz publik shqiptar kjo kosto është rreth 1,800 euro në vit . Kjo nënkupton një diferencë prej rreth 4.5 deri në 5 herë më të lartë për nxënës. Në terma agregatë, për një kapacitet prej 360 nxënësish, kostoja vjetore e Liceut arrin rreth 3.2 milion euro, krahasuar me rreth 648,000 euro për një gjimnaz publik me të njëjtin numër nxënësish . Për më tepër, gjatë pesë viteve të para të funksionimit, kostoja neto për buxhetin e shtetit parashikohet të jetë rreth 10.7 milion			përshtatshëm për këtë rast, pasi Liceu Francez i Korçës është konceptuar si institucion i specializuar me kurrikulë të dyfishtë, staf ndërkombëtar dhe standarde të avancuara, çka justifikon një nivel më të lartë financimi. Gjithashtu, analiza fokusohet vetëm në kosto, pa marrë në konsideratë përfitimet afatgjata në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe ndërkombëtarizi min e sistemit arsimor. Ky institucion synon të shërbejë si model referencë për përmirësimin

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	euro, pa përfshirë plotësisht investimin fillestar në infrastrukturë dhe pajisje. Këto të dhëna ngrenë një çështje thelbësore të efikasitetit të përdorimit të burimeve publike dhe të prioritetëve në politikë bërjen arsimore. Ndërkohë që relacioni justifikon këtë nivel shpenzimesh me standardin më të lartë të arsimit dhe komponentët ndërkombëtarë të programit, mungon një analizë krahasuese mbi efektin alternativ të investimit të këtyre burimeve në sistemin ekzistues të arsimit publik. Në veçanti, alternativa e dytë e analizuar në relacion – zhvillimi			e cilësisë në arsimin publik. Sa i përket alternativave, zhvillimi i një programi brenda një gjimnazi ekzistues nuk garanton të njëjtin fleksibilitet dhe kapacitet për bashkëpunim ndërkombëtar. Në këtë kuadër, niveli i financimit konsiderohet i justifikuar dhe në përputhje me objektivat strategjike të politikës arsimore. Për sa i përket studimit të fizibilitetit, në relacion dhe në RIA-n e dokumentit, janë reflektuar si impakti financiar ashtu edhe studimi i fizibilitetit.

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbli dhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	i një programi të avancuar brenda një gjimnazi ekzistues – refuzohet kryesisht për arsye të fleksibilitetit institucional dhe jo mbi bazën e një analize të thelluar të kostos dhe përfitimit afatgjatë . Kjo sugjeron një orientim politik drejt krijimit të një institucioni të ri elitist, në vend të përmirësimit të kapaciteteve ekzistuese. Në këtë kontekst, lind një problem thelbësor i drejtësisë shpërndarëse: a është e justifikuar që një pjesë e konsiderueshme e fondeve publike të përqendrohet në një institucion që i shërben një numri relativisht të kufizuar nxënësish, ndërkohë që			

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	shumica e gjimnazeve publike përballen me sfida strukturore në cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore? Për më tepër, një diferencë kaq e theksuar në financim për nxënës rrezikon të institucionalizojë pabarazi brenda vetë sistemit publik, duke krijuar një model me dy nivele: një segment të privilegjuar me investim të lartë për nxënës dhe një segment më të gjerë me burime të kufizuara. Nga këndvështrimi i politikave publike, një qasje më efikase dhe më gjithëpërfshirëse do të ishte orientimi i investimeve drejt			

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	përmirësimit të cilësisë në të gjithë sistemin, përfshirë modernizimin e laboratorëve, trajnimit e mësuesve dhe forcimin e standardeve të Maturës Shtetërore. Në mungesë të një strategjie të tillë, krijimi i një institucioni me kosto shumëfish më të lartë për nxënës rrezikon të mos jetë zgjidhja optimale për përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri.			
Pasiguri juridike lidhur me njohjen ndërkombëtare të diplomës	Projektligji dhe relacioni shoqërues theksojnë se një nga përfitimet kryesore të krijimit të Liceut Francez të Korçës është mundësia për pajisjen e nxënësve me një diplomë të dyfishtë, përfshirë Baccalauréat-in	Z. Taulant Muka	I refuzuar	Në pikën 3 të nenit 11 përcaktohet qartë se nxënësi që përfundon me sukses klasën e XII-të (dymbëdhjetë) dhe rezulton kalues në provimet e

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	francez, e cila supozohet të njihet dhe të ketë vlefshmëri në sistemin arsimor francez dhe më gjerë. Megjithatë, analiza e dokumentacionit shoqërues nuk evidenton ekzistencën e një instrumenti të qartë juridik dhe të detyrueshëm ndërmjet palës shqiptare dhe asaj franceze që garanton këtë njohje në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar. Referencat në relacion lidhen kryesisht me bashkëpunimin politik dhe institucional, si dhe me marrëveshje kuadër për projekte prioritare, por nuk paraqitet një marrëveshje specifike, e			Maturës Shtetërore shqiptare dhe asaj franceze, pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore shqiptare dhe me diplomën e Maturës Shtetërore franceze, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse për organizimin dhe realizimin e provimeve të maturës shtetërore. Ky ligj i ka detyrimet brenda Republikës së Shqipërisë, ndaj nuk mund të bëhen më shumë rregullime. Marrëveshja ndërkombëtare G2G është një marrëveshje kuadër që nxit procesin e hapjes

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet per regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe permbledhni komente identike/te ngjashme nga palët e ndryshme te interesuara se bashku)	Palët e interesuara (renditni te gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	ratifikuar, që rregullon në mënyrë të detajuar njohjen e diplomës dhe vlefshmërinë e saj në sistemin arsimor francez. Kjo krijon një nivel të konsiderueshëm pasigurie juridike për një nga elementët themelorë të projektit. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë të qartë dhe të detyrueshme, ekziston rreziku që njohja e diplomës të varet nga vendime administrative të mëvonshme ose nga interpretimi i autoriteteve përkatëse franceze, duke e bërë këtë përfitim potencialisht të pasigurt për nxënësit. Për më tepër, projektligji parashikon që			së këtij institucioni. Nuk shihet e nevojshme hartimi i një marrëveshjeje specifike, pasi secili vend e rregullon mënyrën se si e trajton diplomën e vet të lëshuar prej tij. Nxënësi që përfundon këtë shkollë do të pajiset edhe me diplomën e Maturës Shtetërore shqiptare, e cila i jep akses në IAL shqiptare.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	modalitetet e harmonizimit dhe vlerësimit të kurrikulave të përcaktohen nëpërmjet protokolleve të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve arsimore të dy vendeve. Kjo qasje, që e zhvendos një element thelbësor si njohja e diplomës në akte të mëvonshme dhe potencialisht jo të ratifikuara, dobëson sigurinë juridike dhe transparencën e projektit. Nga perspektiva e politikë bërjes, një projekt që mbështetet në premtimin e një diplome ndërkombëtare duhet të garantojë paraprakisht, në nivel ligjor ose përmes një			

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar, vlefshmërinë e plotë të kësaj diplome. Në të kundërt, ekziston rreziku që pritshmëritë e krijuara tek nxënësit dhe familjet të mos përmbushen plotësisht. Në këtë kuadër, do të ishte e nevojshme që projektligji të shoqërohej me një marrëveshje të qartë dhe të detyrueshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës, e cila të përcaktojë në mënyrë të detajuar statusin juridik të diplomës, mekanizmat e njohjes dhe garancitë për vlefshmërinë e saj ndërkombëtare			